



Istituto Comprensivo Statale Mestre 5 "Lazzaro Spallanzani"

Via Cima d'Asta 8 – 30174 Venezia Tel. 041 877 70 70/041 61 40 07

mail: veic875005@istruzione.it Cod. Min: VEIC875005

DORACAK MIRËSEARDHJEJE I FAMILJEVE ME GJUHË NËNË TJETËR

Mirëseerdhët në shkollën tonë.

Disa informacione të rëndësishme.

Instituti L. Spallanzani mirëpret në shkolla fëmijet nga mosha 3 vjeç deri në moshën 14 vjeç.

- Kopshti nga 3 vjeç deri në 6 vjeç.
- Shkolla fillore cikël i ulët nga 6 vjeç deri në 11 vjeç.
- Shkolla fillore cikël i lartë nga 11 vjeç deri në 14 vjeç.

Informacionet për regjistrimin dhe për shërbimet shkollore të përgjithshme janë në dispozicion në sekretarin e shkollës.

segretaria pret:

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE
11:30 - 12:30	08:30 - 10:30	11:30 - 12:30	11:30 - 12:30	11:30 - 12:30
	15:30 - 16:30	15:30 - 16:30		

Të njëjtan informacione të përkthyer në listën e gjuhëve që vijojnë më poshtë gjenden në faqen e webit të shkollës www.icspallanzanimestre5.edu.it dhe në sekretari:

- INGLESE
- FRANCESE
- SPAGNOLO
- RUMENO
- TURCO
- BANGLA
- CINESE

Orari i shkollës është si më poshtë:

- Kopshti: nga 8:00 deri në 16:00
- Shkolla fillore cikël i ulët nga 8:10 deri në 16:15

Është disponibël një shërbim hyrjeje më i shpejtë nga 7:30 deri në 8:10 (me pagesë).

Është i rëndësishëm respektimi i orareve.

Oraret shkollore mund të ndryshojnë për raste festash, eskursionesh, greva ose për motive të papritura. Duhet kontrolluar gjithmonë lajmërimet.

Në faqen e webit është kalendari me datat kur shkolla është e mbyllur për ditët e festave.



Mësuesit kanë nevojë të kenë disa të dhëna (numra telefoni, autorizime, dokumenta) për t'u lidhur me familjet në rast nevoje.

Në rast problemesh të lidhura me shëndetin (alergji, ilaçe që shpëtojnë jetën ...) familja duhet t'i komunikojë sekretarisë dhe mësuesve.

Fëmijët mund t'u dorëzohen vetëm prindërve. Nëse për ndonjë motiv delegohet një familjar tjetër është i nevojshëm plotësimi i enkas i një moduli dhe i deleguari duhet të paraqisi dokumentat e tij.

Çdo fëmijë ka një librezë për komunikimet. Nevojitet që të shihet çdo ditë për të kontrolluar lajmërimet dhe për të justifikuar mungesat, hyrjet ose daljet para kohe.

Mungesat për sëmundje që zgjasin më shumë se 5 ditë duhet të justifikohen me një raport mjeksor.

Në çdo klasë është një prind (përfaqësues i klasës) që ndihmon mësuesit në organizim dhe mund të jap informacione mbi aktivitetet dhe impenjimet. Është i dobishëm komunikimi me këtë prind.

Në ditët e para të shkollës, mësuesit e çdo klase do të japin informacione mbi materialet shkollore dhe organizimin e brendshëm.

TEAM ACCOGLIENZA (grupi i mirëseardhjes)

Instituti ka një grup mësuesish dhe prindërish i quajtur TEAM ACCOGLIENZA (grupi i mirëseardhjes) që organizon informacione dhe aktivitete të dobishme për përfshirjen e familjeve me një gjuhë nënë tjetër.

Në faqen e webit të shkollës është seksioni i posaçëm.

Shkolla bashkëpunon me vullnetar që ndihmojnë nxënësit në mësim pas orarit shkollor. Ky shërbim zhvillohet në hapësirat e disa kishave të lagjes dhe në rast nevoje janë mësuesit që marrin kontakt.

Lista e letrave informuese në dispozicion dhe të përkthyer.

1. Takim me familjen
2. Autorizimet e prindërve për dalje didaktike
3. Autorizimet e prindërve në hyrje/dalje para kohe
4. Autorizimet e prindërve për mungesa
5. Komunikim i pezullimit të aktiviteteve shkollore
6. Modul delegimi për marrjen e nxënësit nga shkolla